

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT



**TEMA E DIPLOMËS – MASTER**

**ROLI I PJESMARRJES NË AKTIVITETE REKREATIVE SPORTIVE  
DHE NDIKIMI I TYRE NË INDEKsin E MASËS TRUPORE - (BMI) TE  
NXËNËSIT E DY KOMUNAVE TËKOSOVËS**

**Mentori:**  
Prof. Dr. Bujar Turjaka

**Kandidatet:**  
Blertë Kaçiu  
Saranda Daci

**Prishtinë, 2018**

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE .....	3
2. HULUMTIMET E DERITANISHME .....	5
3. QËLLIMI I PUNIMIT .....	8
4. HIPOTEZAT THEMELORE .....	9
5. METODAT E PUNËS .....	10
5.1 MOSTRA E TE ANKETUARVE .....	11
5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	12
5.3 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE .....	13
6. REZULTATET DHE DISKUTIMI.....	14
6.1 FREKUENCA NË PËRGJIGJET NGA PYETËSORI TEMESHKUJT, FEMRATDHE DALLIMI NË MES TYRE NGA PODUJEVA .....	14
6.2 FREKUENCA NË PËRGJIGJET NGA PYETËSORI TE MESHKUJT, FEMRAT DHE DALLIMI NË MES TYRE NGA PEJA.....	26
6.3 FREKUENCA NË PËRGJIGJET NGA PYETËSORI TE FEMRA NGA PEJA DHE PODUJEVA DHE DALLIMI NË MES TYRE.....	39
6.4 FREKUENCA NË PËRGJIGJET NGA PYETËSORI TE MESHKUJT NGA PEJA DHE PODUJEVA DHE DALLIMI NË MES TYRE.....	52
6.5 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR I PËRGJIGJEVE NGA PYETËSORI TE MESHKUJT NGA PODUJEVA .....	65
6.6 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR I PËRGJIGJEVE NGA PYETËSORI TE MESHKUJT NGA PODUJEVA.....	66
6.7 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR I PËRGJIGJEVE NGA PYETËSORI TE MESHKUJT NGA PEJA.....	67
6.8 INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR I PËRGJIGJEVE NGA PYETËSORI TE MESHKUJT NGA PEJA.....	68
6.9 ANALIZA E DALLIMIT .....	69
6.9.1 Dallimi në mes meshkujve nga Podujeva dhe Peja në ndryshoret antropometrike dhe përgjigjet nga pyetësi për stilin e jetesës dhe aktivitetet rekreative sportive .....	69

6.9.2 Dallimi në mes femrave nga Podujeva dhe Peja në ndryshoret antropometrike dhe përgjigjet nga pyetësi për stilin e jetesës dhe aktivitetet rekreative sportive ..... 71

6.9.3 Dallimi në mes meshkujve dhe femrave nga Podujeva në ndryshoret antropometrike dhe përgjigjet nga pyetësi për stilin e jetesës dhe aktivitetet rekreative sportive ..... 72

6.9.4 Dallimi në mes meshkujve dhe femrave nga Peja në ndryshoret antropometrike dhe përgjigjet nga pyetësi për stilin e jetesës dhe aktivitetet rekreative sportive ..... 73

6.11 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE..... 74

7. PËRFUNDIMI ..... 75

8. LITERATURA ..... 77

**1. HYRJE**

Për një jetë më të mirë, më cilësore dhe një prej kushteve më të rëndësishme për shëndet të mirë është pa dyshim levizja. Kryesorja për zhvillimin e personalitetit të përgjithshëm (guximin, përkushtimin, perkatësin grupore, shoqërizimin). Aktiviteti fizik i thjesht do të thotë çdo lëvizje e trupit që lëviz muskujt tuaj dhe kërkon më shumë energji se sa gjatë pushimit. Ecje, vrapim, vallëzim, puna fizike, not, yoga dhe kopshtari janë disa nga shembujt e aktivitetit fizik.

Ndërsa me termin “aktivitet rekreativ nënkuptojmë aktivitetet që përmbajtja e së cilave është sporti dhe turizmi me të cilat merret njeriu me vullnet në kohën e lirë, me qëllim të pushimit, argëtimit dhe zhvillimit të personalitetit vetanë pa ndonjë qëllim të caktuar që do të thotë nuk është qëllim arritja e rezultateve maksimale sportive”

Nëse përdoret siç duhet në përputhje me gjinitë, moshat dhe aftësitë e ndryshme, rekreacioni mund të jetë shumë efektiv.

Njerëzit të cilët bëjnë një jetë të shëndetshme dhe që rregullisht përfshihen në ushtrime, kanë më pak mundësi të zhvillojnë sëmundje kronike, duke përmendur këtu diabetin jo insulin-vartës, sëmundjet kardio-vaskulare, sëmundjet tumorale ose sëmundjet mendore.

Gjithashtu aktivitete fizike rekreative kontrollojnë peshën trupore, sigurojnë lëvizshmëri më të mirë të nyjeve, rrisin forcën e eshtrave, zvogëlojnë rrezikun nga paraqitja e osteoporozës, përmirësojnë ekuilibrin dhe koordinimin, përmirësojnë frymëmarrjen, përmirësim të gjumit , vlerave energjetike etj.

Aktivitetet e grupit në programet rekreative përmirësojnë aftësitë ndërpersonale, pavarësinë dhe vetëvlerësimin pozitiv, të cilat mund të sjellin shumë përfitime në aspektin psikologjik. Kjo si një gamë e gjerë veprimtarish që mund të nxisin funksionimin fizik, psikologjik, social dhe emocional dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës personale tek nxënësit.

Pjesëmarrja në aktivitete rekreative përmirëson mirëqenien fizike. Në fakt, njerëzit që shpesh merren me aktivitete rekreative kanë më pak vizita mjekësore dhe indeks më të ulët të trupit(BMI) sesa ata që nuk bëjnë. Ne besojmë se sporti dhe rekreacioni mund të jenë një mjet i rëndësishëm për ndryshime pozitive në shoqëri.

Rekreacioni sportiv në shoqëri është aktivitet i lirë dhe i organizuar i cili njeriut i mundëson ripërteritje fizike dhe psikike dhe ndihmon në riaftësimin për të gjitha fushat e aktiviteteve jetësore me të cilat merret individ gjatë jetës si dhe në ruajtjen dhe vendosjen edhe të raporteve të shëndosha shoqërore.

Rekreacioni sportiv është fushë specifike e kulturës , që i kenaq nevojat dhe interesat kryesore të njeriut përmes aktiviteteve rekreative – sportive , që i përmbushë nevojat dhe interesat e të gjitha moshave , gjinive dhe kategorive të ndryshme me aftësi dhe gjendje të ndryshme shëndetsore.

Rekreacioni është aktivitet i tërsishem i njeriut jashtë punës profesionale që ai vetë zgjedhë sipas përcaktimit personal me orientim drejt aspiratave pozitive.

Rekreacioni i kontribuon zhvillimit të personalitetit, të kënaqjes së nevojave, interesave për krijimtari, ngritjes së gjendjes së mirë emocionale dhe shkathtësive psikike.

Koha e lirë sot dhe në të ardhmen paraqet sferen vendimtare e cila njeriut i mundëson që ai të jetojë jetën e vetë, e jo të mbijetojë vetëm duke punuar.

Rekreacioni paraqet shprehjen spontane të dëshirës së njeriut për t'i plotësuar nevojat dhe interesat e veta duke u orientuar në aktivitete të zgjedhura sipas dëshirës së vetë me qëllim freskimi, pushimi, zbavitje dhe shfrytëzimit sa më racional të kohës jashtë obligimeve të punës gjatë kohës së lirë.

Rekreacioni mund të jetë efektiv nëse përdoret siç duhet në përputhje me moshat dhe aftësitë e ndryshme.

Efekti i rekreacionit është i gjerë. Ajo rrit aftësinë e vetë-përmbushjes, aftësitë e marrëdhënieve ndërnjerëzore, teknikat dhe metodat e përdorimit të kohës së lirë, forcës fizike, shprehit krijuese dhe ndjenjën estetike. Prandaj, operohen programet rekreative të bazuara në aktivitete fizike të cilat mund t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë zhvillimin fizik dhe emocional dhe të kultivojnë optimizmin.

## **2. HULUMTIMET E DERITANISHME**

Në hulumtimin dhe studimin e literaturës që kemi pasur në dispozicion, në mes tjerash duhet të përmendim këto hulumtime:

**Datalys center for sport.Injury research andprevention-** Një studim i shkollave të mesme publike zbuloi se 29% e djemve dhe 34% e vajzave janë mbipeshë dhe 16% e djemve dhe vajzave janë të plotë. Në këto shkolla, studentët që morën pjesë në një ose më shumë sporte kishin shumë më pak gjasa të ishin mbipeshë ose të plotë. Një studim i vitit 2012 zbuloi se rreth 29% e studentëve në Hampshir dhe Vermont ishin ose mbipeshë ose të plotë, por nxënësit që merrnin pjesë në një ose më shumë ekipe sportive kishin më pak gjasa të jenë mbipeshë ose të plotë në krahasim me jo pjesëmarrësit. Studiuesit vlerësuan se nëse të gjithë adoleshentët do të luanin në një ose më shumë skuadra sportive në vit, obezitetit do ulje me 26%.

**Nihiser AJ, Lee SM, Wechsler H, McKenna M, Odom E, Reinold C, Thompson D, Grummer-Straën L-**Një panel ekspertësh, i thirrur nga Qendrapër Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) në vitin 2005 që përbëhej nga ekspertë të shëndetësisë publike, arsimit, këshillimit shkollor, kujdesit shëndetësor dhe një organizatë e prindërve. Kanë bërë një artikull ku përshkruan qëllimet e programeve të matjes së BMI-së, shqyrton praktikën e tanishme, shqyrton kërkimet ekzistuese, përmbledh rekomandimet e ekspertëve, identifikon shqetësimet dhe siguron udhëzime duke përfshirë një listë të masave mbrojtëse dhe ide për hulumtime të ardhshme. Rezultatet e dala nga ky artikull ishte që zbatimi i matjes së BMI-së me bazë në shkollë për qëllime vëzhgimi, domethënë për të identifikuar përqindjen e nxënësve në një popullatë që është në rrezik për probleme të peshës pranohet gjerësisht mbi matjen e BMI-së për qëllime të shqyrtimit, domethënë, për të vlerësuar gjendjen e peshës së nxënësve dhe për t'i dhënë informacione dhe udhëzime prindërve për veprim.

**Ruggieri DG, Bass SB-** Ndërsa legjislacioni për programet e mbikëqyrjes dhe programeve të shqyrtimit të indeksit të masës trupore (BMI) ka kaluar në 25 shtete, programet shpesh janë subjekt i debateve etike rrethë konfidencialitetit dhe privatësisë, komunikimit nga shkolla në prind, si dhe sigurisë dhe vetëvlerësimit për studentët. Përkundër këtij debati, nuk është përfunduar asnjë analizë gjithëpërfshirëse që krahason dhe kontraston se si këto çështje ndikojnë në mënyrë të ndryshme në shkolla, prindër dhe studentë. Ky artikull trajton hendekun e literaturës së mëparshme duke përvijuar konsideratat etike dhe implikimet që kanë programet e skanimit të BMI-së dhe kartat e raportimit për shkollat, prindërit dhe studentët dhe i lidhë këto me studimet e rezultateve për të adresuar nëse këto polemika mbështeten nga hulumtimi. Pavarësisht polemikave që rrethojnë këto programe, ky rishikim tregon se ato mund të jenë të

vlefshme për të gjitha palët dhe demonstroi që programet e kontrollit të BMI-së janë jetike për zhvillimin e programeve të fuqishme të parandalimit të trashjes në shkollë dhe promovimin e mënyrave të jetesës së shëndetshme në shkollë.

**Burns RD, Fu Y, Hannon JC, Brusseau TA** në një hulumtim të publikuar në **PUBMED** Në shqyrtimin e efektit të një programi gjithëpërfshirës të aktivitetit fizik në shkollë (CSPAP) mbi aftësitë motorike të fëmijët ku u përfishin 959 fëmijë nga 5 shkollë. Të dhënat u grumbulluan në fillim të vitit shkollor dhe në fund të 36 javorit të hulumtimit. Aftësitë motorike u vlerësuan duke përdorur testin për zhvillimin e brendshëm të aftësive motorike duke u bazuar në moshën dhe gjininë si modifikues të efektit dhe duke përshtatur për grumbullimin e vëzhgimeve brenda strukturës së të dhënave. Fëmijët treguan rezultate të përmirësuar të aftësisë motorike bruto në fund të 36 javorit hulumtues.

**Chace M, Vilvens H.**-Marrëveshjet e përdorimit të përbashkët (SUA) që lejojnë përdorimin e objekteve shkollore publike nga komuniteti janë rekomanduar si një nga strategjit kryesore për shëndetin publik dhe për rritjen e aktivitetit fizik. Qëllimi i këtij studimi ishte të shqyrtojë natyrën dhe shtrirjen aktuale të SUA në Ohajo, si dhe përfitimet, pengesat dhe nevojat e përceptuara të administratorëve shkollorë. Përfitimet e përceptuara më së shpeshti përfshijnë përmirësimin e marrëdhënieve me tatimpaguesit. Sipas administratorëve të shkollave, dyert e tyre janë të hapura deri në një farë mase, por shumica e SUA-s ishin marrëveshje joformale. Përpjekjet e avokimit për SUA duhet të përfshijnë kalimin e një ligji të nivelit shtetëror që siguron imunitet të arsyeshëm ndaj përgjegjësisë. Përhapja në komunitetin e shkollës duhet të përfshijë shembuj të marrëveshjeve zyrtare me shkrim, shembuj të menaxhimit të kostos novatore dhe hulumtime të përditësuara mbi lidhjen e aktivitetit fizik me mësimnxënien dhe performancën akademike.

**Kaltrina Selmanaj & Ermira Simitxhiu (2017)** -Në përgjithsi rinia e moshës 16-17 vjeçare e tri qyteteve të Kosovës nuk janë të rrezikuara nga tendenca e theksuar e mbipeshës. Dallimet të cilat egzistojnë në nivel të përfshirësisë në aktivitete rekreative-sportive janë të theksuara në mes të femrave dhe meshkujve të kësaj moshe. Meshkujt janë dukshëm më shumë të përfshirë në aktivitetet rekreative dhe në klube sportive. Shprehjet pozitive që ndërlidhen me aktivitetin fizik, aktivitetet rekreative janë më të theksuara te gjinia e meshkujve se te e femrav. Dallimet në

përfshirje në aktivitete rekreative - sportive si dhe në shprehi të ndryshme të jetuarit nuk janë të theksuara në bazë të përkatsis së të rinjëve qytetëve të ndryshme të Kosovës.

*Gene Sinani (2018)* – Është vërtetuar se rezultatet e fituara rezultojnë me një përqindje më të madhe të marrjes me aktivitete rekreative sportive tek femrat e grup moshave 17-18 vjeqare se sa tek meshkujt e po të njejtës moshë.

Dallimet janë vërtetuar edhe rrethë konsumit të alkoolit. Është vërtetuar se djemtë e moshës 15-16 vjeq konsumojnë më tepër alkool se sa femrat e po të njejtës moshë sikur edhe më shumë se sa meshkujt e moshës 17-18 vjeqare.

Dallimet janë vërtetuar edhe në atë se sa ore gjumë i bëjnë. Ku është vërtetuar se meshkujt e moshës 17-18 vjeqare kalojnë me shumë ore gjumë gjatë ditës se sa meshkujt e moshës 15-16 vjeqare.

Dallimet janë vërtetuar edhe lidhur me preferencën e tyre për t'u marrë me sport po të kishit mundësi ku është vërtetuar se femrat e moshës 15-16 vjeqare janë më pak të predispozuara sesa femrat e moshës 17-18 vjeqare për t'u marrë me aktivitete sportive po të kishin mundësi.

### **3. QËLLIMI I PUNIMIT**

Prezantimi i nivelit të marrjes me aktivitete rekreative sportive në shkollat e mesme, llojet e tyre, koha më e preferuar e marrjes me aktivitete sportive, vetëdisimi për benefitet që sjellë aktiviteti i



rregullt sportive si dhe një qëllim shumë me rëndësi, parandalimi i mbipeshes pasi që dita e ditës ky fenomen është në rritje e sipër.

Ky studim ka për qëllim të hulumtoj efektet e stilit të jetesës dhe aktiviteteve fizike rekreative në indeksin e masës trupore (BMI) të rinija e shkollave të mesme të lartë.

Qëllim kryesor në këtë punim është niveli ipjesëmarrjës së rinisëme aktivitete rekreative sportive, llojet e aktiviteteve,dhe shprehitë individuale jetësore.

Qëllim sekundar është që përmes pyetsorit të informohemi për aktivitetet rekreativo-sportive, dhe shprehitë,në nivelë të komunave të trajtuar për të dy gjinitë.

Qëllimi terciar i këtij punimi është që në bazë të variablave të peshës dhe lartësisë së trupit të nxjerrët vlera e BMI-së në mostrën e ndarë sipas gjinsë dhe qyteteve të trajtuara, të vërtetohet ndikimi i aktiviteteve rekreative sportive në indeksin e masës trupor - (BMI)

Qëllimi teorik i hulumtimit është të tregojë se nxënësit të cilët janë të angazhuar në rekreacionin sportiv kanë një vetëdije më të lartë për rëndësinë e aktivitetit sportiv sesa ata të cilët nuk janë të përfshirë në sport si dhe fitojnë shprehi të re të jetesës në drejtimë të përmirësimit të shëndetit.Të nxjerrët ndonjë konkludimi për punën e mirë profesionale apo mungesës së kushteve nëpër shkolla.

Qëllimi praktik i hulumtimit është që në bazë të hulumtimeve të fitohen të dhëna të vlefëshme dhe interesante rrethë vetëdijes së nxënësve mbi edukimin fizik si dhe pengesat që paraqiten për mospjesëmarrje aktive në sporte të ndryshme.

#### **4. HIPOTEZAT THEMELORE**

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve parashtrohen këto hipoteza:

H<sub>01</sub>– Presim se do të paraqiten dallime të rëndësishme në mes rinisë të ndarë sipas gjinisë të trajtuara në punim në kuptimin e pjesëmarrjes aktive në aktivitete rekreative sportive.

H<sub>02</sub>– Presim se do të paraqitendallime të rëndësishme në mes rinisë të ndarë sipas qyteteve në kuptimin e pjesëmarrjes aktive në aktivitete rekreativo-sportive.

H<sub>03</sub>- Presim se do të paraqitendallime të rëndësishme në mes rinisë të ndar sipas gjinive në kuptimin e shprehive individuale.

H<sub>04</sub>- Presim se do të të paraqiten dallime të rëndësishme në mes rinisë të ndarë sipas qyteteve në kuptimin e shprehive individuale.

## 5. METODAT E PUNËS

Sipas natyrës së kërkimit shkencor ky studim i përket kategorisë së kërkimeve empirike, ndërsa sipas qëllimit tëndërmarrë paraqet hulumtim aplikativ i cilaka për qëllime fituarit enjohurive dhe informacioneve të reja të nevojshëm për aplikim praktik në fushën e sportit, dhë marrë në tërësi, në praktikën pedagogjike në shkollë.

Çdo problem hulumtues është e mundur të operacionalizohet në shumë mënyra të ndryshme. Megjithatë, natyra e shumicës së problemeve dhe karakteristikave të proceseve shpesh kërkojnë një qasje multivariante.

Në lidhje mënjohjëne problemit, ky studim paraqethulumtimkonfirmativku në bazë të një problemi të njohur kryhet kontrolli i hipotezave të parashtruara duke përdorurmetoda të përshtatshmekërkimore.

Në kushtet e përcaktimitkohor,studimi ështëi karakterit transfersal,dhe konsiston nënjë matjetë vetmetë treguesvepërkatëstë karakteristikavemorfolgjike,të cilët janë aktiv në sporte përkatëse.

Ky hulumtimshkencor i përket ose bienë kategorinë ehulumtimit shkencore në teren që do të kryhet ose realizohetnë kushtenatyrore tëjetës.

## **5.1 MOSTRA E TE ANKETUARVE**

Mostra për këtë punim është definuar si nxënës të moshës 16-17 vjeçare të shkollave të mesme (Podujevë dhe Pejë). Mostra në këtë punim ka përfshirë 400 nxënës, të anketuar të dy komunave të Kosovës nga 200 nxënës të secilës komunitet të dyja gjinive. Grupin e të anketuarve e kanë përbër nxënësit e kalsëve të njëmbëdhjeta (XI) ,nga 100 femra dhe 100 meshkuj të secilës komunë.

## 5.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE

Si instrument i hulumtimit është përdor pyetësi, i modifikuar dhe riformuluar për këtë hulumtim. Një grup i pyetjeve ka siguruar të dhëna rrethë pjesëmarrjes në aktivitete dhe llojin e tyre, ndërsa grupi tjetër i pyetjeve ka të bëjë në vlerësimin e shprehive të jetesës të të anketuarave si indikator ose tregues kryesor janë të dhëna dhe përshkrimet e aktiviteteve të mëposhtme të cilat konsiderohen si shprehje të jetesës: Pirja e cigareve, konsumimi i alkoolit, ushqimi i rregullt, gjumi i rregullt dhe marrja me aktivitete rekreative – sportive si dhe shprehjet e jetesës. Pyetësi është i bashkëngjitur në shtojcë.

Po ashtu si variabla janë përfshi edhe lartësia e trupit dhe masa e trupit përmes të cilave është përcaktuar Indeksi i Masës Trupore (BMI).

### 5.3 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë qëkërkimi shkencorqë të jepë zgjidhjetë kënaqshme, është e nevojshmeqë të përdorenprocedurat e duhura, të drejta dhe komparative e qëjanë të natyrës së atijproblemi tëdhënë.

Për realizimin e qëllimit të këtij hulumtimi janë zgjedhë proceduratpër të cilat konsiderohetsekorrespondojnë menatyren eproblemeve qëdo të hulumtohen.

Për çdovariabël të pyetsorit, janë llogariturvlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qëndrore themelor dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma),
- Devijimi standard (Ds),
- Vlera minimale (Min),
- Vlera maksimale (Max).

2. Lakorja e distribucionit ose e shpërndarjesështë testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („skjunis”), dhe shkalla e lakimit të majës së kurbës sërezultateve të shpërndara (lartësia e distribucionit) përmes koeficientit të sheshtë(„kurtozis”).

3. Për vërtetimin e dallimeve brenda grupit dhe ndermjet grupeve është aplikuar Hi-katror testi

4. Nga hapësirat e statistikës komparative (krahasuese) për grupe të mostrave të pavarura të ndarë sipas gjinisë dhe qyteteve është përdorr procedura diskriminative, para së gjithash, analiza e dallimeve( t-testi).

## 6. REZULTATET DHE DISKUTIMI

### 6.1 FREKUENCA NË PËRGJIGJET NGA PYETËSORI TE MESHKUJT, FEMRAT DHE DALLIMI NË MES TYRE NGA PODUJEVA

Në këtë punim nga parametrat themelorë statistikore është llogaritur Hi-katror testi mbrenda grupit dhe ndërmjet grupeve nga Podujeva. Në pyetjen a merreni me aktivitete rekreative sportive ( Tabela 1 ) 21 nxënës apo 21% janë përgjigjur që merren rregullisht me aktivitete sportive, ndërsa 75 nxënës apo 75% janë përgjigjur kohë pas kohe dhe 4 nxënës apo 4% janë përgjigjur asnjëherë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P=0.000$ . Sa i përket nxënësve 38 nxënës apo 38% janë përgjigjur që merren rregullisht me aktivitete sportive, ndërsa 57 nxënës apo 57 % janë përgjigjur kohë pas kohe dhe 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur asnjëherë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P=0.000$ . Në mes grupeve ekziston një dallim ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P=0.023$ ,  $P<0.05$ .

**Tabela 1.A merreni me aktivitete rekreative sportive?**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva – Femrat			Meshkuj- Femra
I rregullt (së paku)	Observed	Expected	Residual	Observed	Expected	Residual	$\Sigma$
3 herë në javë	38	33.3	4.7	21	33.3	-12.3	59
Kohë pas kohe	57	33.3	23.7	75	33.3	41.7	132
Asnjëherë	5	33.3	-28.3	4	33.3	-29.3	9
Total	100			100			200

Podujeva – Meshkujt				Podujeva – Femrat			Meshkuj- Femra
I rregullt (së paku)	Observed	Expected	Residual	Observed	Expected	Residual	$\Sigma$
3 herë në javë	38	33.3	4.7	21	33.3	-12.3	59
Kohë pas kohe	57	33.3	23.7	75	33.3	41.7	132
Asnjëherë	5	33.3	-28.3	4	33.3	-29.3	9
$\chi^2$	$\chi^2=41.54$			$\chi^2=82.46$			$\chi^2=7.436$
	df: 2			df: 2			df: 2
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.023

### A jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sportë?

Në pyetjen a jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sportë ( Tabela 2 ) 19 nxënës apo 19% janë përgjigjur me Po, ndersa 81 nxënës apo 81% janë përgjigjur Jo,ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ .

Sa i përket nxënësve 53 nxënës apo 53% janë përgjigjur Po, ndersa 47 nxënës apo 47 % janë përgjigjur Jo ku shifet se mbrenda grupit nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.548$ .

Në mes grupeve ekziston një dallim ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ ,  $P < 0.05$ .

**Tabela 2. A jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sportë?**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva – Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expecte d N	Residual	Observed N	Expecte d N	Residual	$\Sigma$
Po	53	50	3	19	50	-31	72
Jo	47	50	-3	81	50	31	128
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=0.36$ df: 1 P= 0.548			$\chi^2=38.44$ df: 1 P= 0.000			$\chi^2=23.633$ df: 1 p=0.000

**Me cilin sport do të mirreshit po të kishit mundësi?**

Në pyetjen me cilin sport do të merreshit nëse do kishit mundësi (Tabela 3). Në bazë të dhënave nga të anketuarat del se nga 100 femra të Podujevës 7 nga to apo 7% janë përgjigjur për Futboll, 64 vajza apo 64% për Basketboll, 14 vajza apo 14% Hendboll, 2 vajza apo 2% Volejboll, 2 vajza apo 2% Tenis, 3 vajza apo 3% për Not, 2 vajze apo 2% për Gjimnasikë dhe 3 vajza apo 3% për Atletikë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000.Sa i përket nxënësve 50 nga to apo 50% janë përgjigjur për Futboll, 16 djem apo 16% për Basketboll, 24 djem apo 24% Hendboll, 2 djem apo 2% Volejboll, 3 djem apo 3% Tenis, 2 djem apo 2% për Not, 1 djal apo 1% për Gjimnasikë, 1 djal apo 1% për Atletikë dhe 1 djal apo 1% për Boks ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000.Në mes grupeve ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000, P< 0.05.

**Tabela 3. Me cilin sport do të merreshit nëse do kishit mundësi?**

Podujeva – Meshkujt	Podujeva - Femrat	Meshkuj- Femra



	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Futboll	50	11.1	38.9	7	12.5	-5.5	57
Basketboll	16	11.1	4.9	64	12.5	51.5	80
Hendboll	24	11.1	12.9	14	12.5	1.5	38
Volejboll	2	11.1	-9.1	2	12.5	-10.5	4
Tenis	3	11.1	-8.1	7	12.5	-5.5	10
Noti	2	11.1	-9.1	1	12.5	-11.5	3
Gjimmastikë	1	11.1	-10.1	2	12.5	-10.5	3
Atletikë	1	11.1	-10.1	3	12.5	-9.5	4
Boks	1	11.1	-10.1	0	0	0	1
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=201.68$ df: 8 p=0.000			$\chi^2=252.64$ df: 7 P= 0.000			$\chi^2=68.14$ df: 8 p=0.000

### Organizimi i aktiviteteve sportive rekreative a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj?

Në pytjen organizimi i aktiviteteve sportive rekreative a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj ( Tabela 4 ) 20 nxënese apo 20% janë përgjigjur nuk jam e sigurt, 35 nxënese apo 35% janë përgjigjur po, 20 nxënese apo 20% janë përgjigjur jo dhe 25 nxënese apo 25% janë përgjigjur mjaftueshëm ku shifet se mbrenda grupit nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P=0.111$ . Sa i përket nxënësve 14 nxënës apo 14% janë përgjigjur nuk jam i sigurt, 40 nxënës apo 40% janë përgjigjur po, 27 nxënese apo 27% janë përgjigjur jo dhe 19 nxënese apo 19% janë përgjigjur mjaftueshëm ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P=0.001$ . Në mes grupeve nuk ekziston një dallim ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P=0.354$ ,  $P<0.05$ .

### Tabela 4.Organizimi i aktiviteteve sportive a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj?

Podujeva – Meshkujt			Podujeva – Femrat			Meshkuj - Femra	
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Nuk jam i sigurt	14	25.0	-11.0	20	25.0	-5.0	34
Po	40	25.0	15.0	35	25.0	10.0	75
Jo	27	25.0	2.0	20	25.0	-5.0	47
Mjaftueshëm	19	25.0	-6.0	25	25.0	.0	44
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=15.44$			$\chi^2=6.64$			$\chi^2=3.25$
	df: 3			df:3			df: 3
	P= 0.001			P= 0.111			P= 0.354

### A do të dëshironit të humbnit peshë dhe të mirëmbani formën trupore?

Në pyetjen a do të dëshironit të humbnit peshë dhe të mirëmbani formën trupore (Tabela 5) 74 nxënës apo 74% janë përgjigjur po, ndersa 26 nxënës apo 26% janë përgjigjur jo ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Sa i përket nxënësve 71 nxënës apo 71% janë përgjigjur po, ndersa 29 nxënës apo 29 % janë përgjigjur ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.634$ ,  $P < 0.05$ .

**Tabela 5. A do të dëshironit të humbnit peshë dhe të mirëmbani formen trupore?**

Podujeva – Meshkujt			Podujeva – Femrat			Meshkuj- Femra	
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Po	71	50.0	21.0	74	50.0	24.0	145
Jo	29	50.0	-21.0	26	50.0	-24.0	55
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=17.64$			$\chi^2=23.04$			$\chi^2=0.22$
	df: 1			df:1			df:1
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.634

**A jeni të informuar për ndikimin e aktivitetit fizik në shëndet?**

Në pyetjen a jeni të informuar për ndikimin e aktivitetit fizik në shëndet (Tabela 6) 74 nxënës apo 74% janë përgjigjur po, 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur jo, 16 nxënës apo 16% janë përgjigjur mesatarisht dhe 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur mjaftushëm ku shifet se brenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Sa i përket nxënësve 75 nxënës apo 75% janë përgjigjur po, 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur jo, 18 nxënës apo 18% janë përgjigjur mesatarisht dhe 2 nxënës apo 2% janë përgjigjur mjaftushëm ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikot  $P= 0.000$ . Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.703$ ,  $P> 0.05$

**Tabela 6. A jeni të informuar për ndikimin e aktivitetit fizik në shëndet?**

Podujeva – Meshkujt			Podujeva – Femrat			Meshkuj- Femra	
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Po	75	25.0	50.0	74	25.0	49.0	149
Jo	5	25.0	-20.0	5	25.0	-20.0	10
Mesatarisht	18	25.0	-7.0	16	25.0	-9.0	34
Mjaftueshëm	2	25.0	-23.0	5	25.0	-20.0	7
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=132.12$			$\chi^2=131.28$			$\chi^2=1.41$
	df: 3			df:3			df:3
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.703

**Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor?**

Në pyetjenfrekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor ( Tabela 7 ) 6 nxënese apo 6% janë përgjigjur që përdorin deri 10 cigare, 2 nxënese apo 2% janë përgjigjur që përdorin 11-20 cigare, 0 nxënese apo 0% janë përgjigjur që nuk përdorin më tepër se 20 cigare dhe 92 nxënese apo 92% janë përgjigjur që nuk e konsumoj ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000. Sa i përket nxënësve 6 nxënës apo 6% janë përgjigjur që përdorin deri 10 cigare,3 nxënës apo 3% janë përgjigjur që përdorin 11-20 cigare, 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur që nuk përdorin më tepër se 20 cigare dhe 86 nxënës apo 86% janë përgjigjur që nuk e konsumoj ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000. Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.144, P> 0.05.

**Tabela 7. Frekuenca e konsumimit të cigareve. Konsumimi ditor?**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva – Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Deri 10 cigare	6	25.0	-19.0	6	33.3	-27.3	12
11-20 cigare në ditë	3	25.0	-22.0	2	33.3	-31.3	5
Mëteper se 20 cigarenëditë	5	25.0	-20.0	0	0	0	5
Nuk e konsumoj	86	25.0	61.0	92	33.3	58.7	178
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=198.64$			$\chi^2=240.16$			$\chi^2=5.40$
	df: 3			df:3			df:3
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.144

### Konsumimi i alkoolit?

Në pyetjenkonsumimi i alkoolit ditor (Tabela 8) 1 nxënëse apo 1% është përgjigjur që përdorë rregullishtë , 98 nxënëse apo 98% janë përgjigjur që nuk e konsumoj dhe 1 nxënëse apo 1% është përgjigjur që kohë pas kohe ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000.Sa i përket nxënësve 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur që përdorinë rregullishtë,6 nxënës apo 6% janë përgjigjur që nuk e konsumoj dhe 89 nxënës apo 89% janë përgjigjur që përdorin kohë pas koheku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikot P= 0.000.Në mes grupeve ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000, P< 0.05.

### Tabela 8. Konsumimi i alkoolit?

Podujeva – Meshkujt				Podujeva – Femrat			Meshkuj-Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Rregullishtë	5	33.3	-28.3	1	33.3	-32.3	6
Nuk konsumoj	6	33.3	-27.3	98	33.3	64.7	104
Kohë pas kohe	89	33.3	55.7	1	33.3	-32.3	90
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=139.46$			$\chi^2=188.18$			$\chi^2=165.22$
	df: 2			df:2			df:2
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.000

### Shprehitë në ushqim, shujta ditore?

Në pyetjen shprehitë në ushqim, shujta ditore (Tabela 9) 12 nxënës apo 12% janë përgjigjur që ushqehen 1 herë në ditë , 51 nxënës apo 51% janë përgjigjur që ushqehen 2 herë në ditë, 25 nxënës apo 25% janë përgjigjur që ushqehen 3 herë në ditë dhe 12 nxënës apo 12% janë përgjigjur që ushqehen 4 herë në ditë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ .Sa i përket nxënësve 9 nxënës apo 9% janë përgjigjur që ushqehen 1 herë në ditë,34 nxënës apo 34% janë përgjigjur që ushqehen 2 herë në ditë, 43 nxënës apo 43% janë përgjigjur që ushqehen 3 herë në ditë dhe 14 nxënës apo 14% janë përgjigjur që ushqehen 4 herë në ditë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikot  $P= 0.000$ .Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.057$ ,  $P< 0.05$ .

**Tabela 9. Shprehitë në ushqim, shujta ditore?**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva - Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
1 herë në ditë	9	25.0	-16.0	12	25.0	-13.0	21
2 herë në ditë	34	25.0	9.0	51	25.0	26.0	85
3 herë në ditë	43	25.0	18.0	25	25.0	.0	68
4 herë në ditë	14	25.0	-11.0	12	25.0	-13.0	26
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=31.28$ df: 3 P= 0.000			$\chi^2=40.56$ df:3 P= 0.000			$\chi^2=7.49$ df:3 P= 0.057

**Sa orë gjumë bëni ?**

Në pyetjensja orë gjumë bëni ( Tabela 10 ) 19 nxënës apo 19% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 5-6 orë), 19 nxënës apo 19% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 7-8 orë , 24 nxënës apo 24% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 9-10 orë,22 nxënës apo 22% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 11-12 orë dhe 16 nxënës apo 16% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 13-14 orë ku shifet se mbrenda grupit nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.754$ . Sa i përket nxënësve 22 nxënës apo 22% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 5-6 orë,11 nxënës apo 11% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 7-8 orë,22 nxënës apo 22% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 9-10 orë,23 nxënës apo 23% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 11-12 orë dhe 22 nxënës apo 22% janë përgjigjur që bëjnë gjumë 13-14 orë ku shifet se mbrenda grupit nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.277$ . Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.660$ ,  $P>0.05$ .

**Tabela 10. Sa orë gjumë bëni:**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva - Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
5-6 orë	22	20.0	2.0	19	20.0	-1.0	41
7-8 orë	11	20.0	-9.0	19	20.0	-1.0	30
9-10 orë	22	20.0	2.0	24	20.0	4.0	46
11-12 orë	23	20.0	3.0	22	20.0	2.0	45
13-14 orë	22	20.0	2.0	16	20.0	-4.0	38
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=5.10$			$\chi^2=1.90$			$\chi^2=0.49$
	df: 4			df:4			df:4
	P= 0.277			P= 0.754			P= 0.660

### A jeni person i qetë dhe a e menaxhoni mirë situaten?

Në pyetjen a jeni person i qetë dhe a e menaxhoni mirë situaten (Tabela 11) 56 nxënës apo 56% janë përgjigjur po, 5 nxënës apo 5% janë përgjigjur jo, 38 nxënës apo 38% janë përgjigjur ndonjëher dhe 1 nxënës apo 1% është përgjigjur asnjëher ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Sa i përket nxënësve 65 nxënës apo 65% janë përgjigjur po, 11 nxënës apo 11% janë përgjigjur jo, 23 nxënës apo 23% janë përgjigjur ndonjëher dhe 1 nxënës apo 1% janë përgjigjur asnjëher ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.121$ ,  $P> 0.05$ .



**Tabela 11. A jeni person i qetë dhe a e menaxhoni mirë situatën?**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva - Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	$\Sigma$
Po	65	25.0	40.0	56	25.0	31.0	121
Jo	11	25.0	-14.0	5	25.0	-20.0	16
Ndonjëher	23	25.0	-2.0	38	25.0	13.0	61
Asnjëher	1	25.0	-24.0	1	25.0	-24.0	2
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=95.04$ df: 3 P= 0.000			$\chi^2=84.24$ df:3 P= 0.000			$\chi^2=5.80$ df:3 P= 0.121

**Sa konsumoni ujë gjatë një dite?**

Në pyetjensja konsumoni ujë gjatë një dite (Tabela 12), 31 nxënës apo 31% janë përgjigjur që përdorin ujë 2-4 gota, 19 nxënës apo 19% janë përgjigjur që përdorin ujë 5-6 gota, 17 nxënës apo 17% janë përgjigjur që përdorin ujë 7-8 gota, 33 nxënës apo 33% janë përgjigjur që përdorin ujë 9-10 gota dhe 10 nxënës apo 10% janë përgjigjur që nuk përdorin ujë më tepër se 10 gota ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Sa i përket nxënësve 15 nxënës apo 15% janë përgjigjur që përdorin ujë 2-4 gota, 16 nxënës apo 16% janë përgjigjur që përdorin ujë 5-6 gota, 24 nxënës apo 24% janë përgjigjur që përdorin ujë 7-8 gota, 44 nxënës apo 44% janë përgjigjur që përdorin ujë 9-10 gota dhe 1 nxënës apo 1% është përgjigjur që nuk përdor më tepër se 10 gota ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Në mes grupeve nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.126$ ,  $P > 0.05$ .

**Tabela 12. Sa konsumoni ujë gjatë një dite?**

Podujeva – Meshkujt				Podujeva - Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	∑
2-4 gota	15	20.0	-5.0	31	25.0	6.0	46
5-6 gota	16	20.0	-4.0	19	25.0	-6.0	35
7-8 gota	24	20.0	4.0	17	25.0	-8.0	41
9-10gota	44	20.0	24.0	33	25.0	8.0	77
Më tepër se 10	1	20.0	-19.0	0	0	0	1
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=49.70$			$\chi^2=35.00$			$\chi^2=7.18$
	df: 4			df:4			df:4
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.126

## 6.2 FREKUENCA NË PËRGJIGJET NGA PYETËSORI TE MESHKUJT, FEMRAT DHE DALLIMI NË MES TYRE NGA PEJA

Në këtë punim nga parametrat themelorë statistikore janë llogaritur frekuencat , përqindjet dhe përqindjet kumulative për të paraqitur shpërndarjen e rezultateve të përgjigjeve të respondenteve në pyetjet rrethë opinioneve të nxënësve dhe nxënësve lidhur me aktivitetet fizike dhe shprehite e jetës së të rinjëve në komunën e Pejës.

Në pyetjen a merreni me aktivitete rekreative sportive (Tabela 13),34 nxënës apo 34% janë përgjigjur që merren 3 herë në javë, 54 nxënës apo 54% janë përgjigjur kohë pas kohe dhe 12 nxënës apo 12% janë përgjigjur asnjëherë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikot P= 0.000. Sa i përket nxënësve 51 nxënës apo 51% janë përgjigjur që merren 3 herë në javë, 41 nxënës apo 41% janë përgjigjur kohë pas kohe dhe 8 nxënës apo 8% janë përgjigjur asnjëherë ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000. Në mes grupeve ekziston një dallim ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.050, P< 0.05.

Tabela 13.A merreni me aktivitete rekreative sportive?

Peja – Meshkujt			Peja – Femrat			Meshkuj- Femra	
I rregullt (së paku)	Observed	Expected	Residual	Observed	Expected	Residual	$\Sigma$
3 herë në javë	51	33.3	17.7	34	33.3	.7	85
Kohë pas kohe	41	33.3	7.7	54	33.3	20.7	95
Asnjëherë	8	33.3	-25.3	12	33.3	-21.3	20
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=30.38$			$\chi^2=26.48$			$\chi^2=5.98$
	df: 2			df: 2			df: 2
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.050

### A jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sportë?

Në pyetjen a jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sportë (Tabela 14), 39 nxënës apo 19% janë përgjigjur me Po, ndërsa 61 nxënës apo 61% janë përgjigjur Jo, ku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.027$ . Sa i përket nxënësve 58 nxënës apo 58% janë përgjigjur Po, ndërsa 42 nxënës apo 42 % janë përgjigjur Jo ku shifet se mbrenda grupit nuk ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.109$ . Në mes grupeve ekziston një dallim ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.001$ ,  $P < 0.05$ .

**Tabela 14. A jeni pjesëmarrës aktiv në ndonje sportë?**

Peja – Meshkujt			Peja – Femrat			Meshkuj- Femra	
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	Σ
Po	58	50.0	8.0	39	50.0	-11.0	108
Jo	42	50.0	-8.0	61	50.0	11.0	92
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=2.56$			$\chi^2=4.84$			$\chi^2= 7.23$
	df: 1			df: 1			df: 1
	P= 0.109			P= 0.027			P= 0.001

**Me cilin sport do të merreshit po të kishit mundësi?**

Në pyetjen me cilin sport do të merreshit nëse do kishit mundësi (Tabela 15). Në bazë të dhënave nga të anketuarat del se nga 100 femra të Pejës 30 nga to apo 30% janë përgjigjur për Futboll, 21 vajza apo 21% për Basketboll, 8 vajza apo 8% Hendboll, 8 vajza apo 8% Volejbol, 5 vajza apo 5% Tenis, 5 vajza apo 5% për Not, 5 vajza apo 5% për Gjimnasikë, 4 vajza apo 4% për Atletikë, 2 vajza apo 2% për Boks, 2 vajza apo 2% për Xhudo, 2 vajza apo 2% për Ping pong, 2 vajza apo 2% për Skijim, 1 vajzë apo 1% për Kikboks, 1 vajzë apo 1% për Sërf, 1 vajzë apo 1% për Ragbi, 1 vajzë apo 1% për Fitnes, 1 vajzë apo 1% për Balet, 1 vajzë apo 1% për Hokejku shifet se mbrenda grupit ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor P= 0.000. Sa i përket nxënësve, 9 nga ta apo 9% janë përgjigjur për Futboll, 11 djemë apo 11% për Basketboll, 21 djemë apo 21% për Hendboll, 4 djemë apo 4% Volejbol, 18 djemë apo 18% Tenis, 10 djemë apo 10% për Not, 2 djemë apo 2% për Gjimnasikë, 3 djemë apo 3% për Atletikë, 5 djemë apo 5% për Boks, 2 djemë apo 2% për Xhudo, 1 djalë apo 1% për Pingpong, 1 djalë apo 1% për Skijim, 3 djemë apo 3% për Kikboks, 2 djemë apo 2% për Serf, 1 djalë apo 1% për Ragbi, 1 djalë apo 1% për Fitnes, 6 djemë apo 6% për Balet dhe 0 djemë apo 0% për Hokej, ku shifet se mbrenda grupit

ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ . Në mes grupeve ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor  $P= 0.000$ ,  $P< 0.05$ .

**Tabela 15. Me cilin sport do të merreshit nëse do kishit mundësi?**

	Peja – Meshkujt			Peja – Femrat			Meshkuj- Femra
	Observed N	Expected N	Residual	Observed N	Expected N	Residual	
Futboll	9	5.9	3.1	30	5.6	24.4	39
Basketboll	11	5.9	5.1	21	5.6	15.4	32
Hendboll	21	5.9	15.1	8	5.6	2.4	29
Volejboll	4	5.9	-1.9	8	5.6	2.4	12
Tenis	18	5.9	12.1	5	5.6	-0.6	23
Noti	10	5.9	4.1	5	5.6	-0.6	15
Gjymnastikë	2	5.9	-3.9	5	5.6	-0.6	7
Atletikë	3	5.9	-2.9	4	5.6	-1.6	7
Boks	5	5.9	-0.9	2	5.6	-3.6	7
Xhudo	2	5.9	-3.9	2	5.6	-3.6	4

Pingpong	1	5.9	-4.9	2	5.6	-3.6	3
Skijim	1	5.9	-4.9	2	5.6	-3.6	3
Kikboks	3	5.9	-2.9	1	5.6	-4.6	4
Serf	2	5.9	-3.9	1	5.6	-4.6	3
Ragbi	1	5.9	-4.9	1	5.6	-4.6	2
Fitness	1	5.9	-4.9	1	5.6	-4.6	2
Balet	6	5.9	0.1	1	5.6	-4.6	7
Hokej	0	0	0	1	5.6	-4.6	1
Total	100			100			200
$\chi^2$	$\chi^2=42.2$			$\chi^2=58.04$			$\chi^2=27.76$
	df: 17			df: 17			df: 17
	P= 0.000			P= 0.000			P= 0.000

### Organizimi i aktiviteteve sportive rekreative a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj?

